



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 261, Datë 31.08.2023**

**MBI**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HIDROPOWER ELEKTRIK” SH.P.K.,  
PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE NR. 167, DATË  
05.08.2021**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, “Kodit të Transmetimit” i miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 63, datë 12.04.2022; si dhe neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.08.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1284/4 prot., datë 28.08.2023 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., mbi zgjatjen e afatit të vendimit të bordit të ERE nr. 167, datë 05.08.2021”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., është mbajtëse e licencës Nr. 130, SERIA PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 59, datë 22.06.2011, për një afat 30-vjeçar, modifikuar me vendimin e bordit të ERE nr. 194, datë 30.08.2018, si dhe mbajtëse e licencës Nr. 267, Seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 19, datë 11.02.2015, për një afat 26-vjeçar.
- Shoqëria “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., është zotëruese e HEC “Sllabinja 2B”, me fuqi të instaluar 1800 kW; HEC “Sllabinja 2C” me fuqi të instaluar 3400 kW; HEC “Sllabinja 2D&2D/1” me fuqi të instaluar N/1. = 4 885 kW dhe N/2. =1 200 kW); HEC “Sllabinja 2E” me fuqi të instaluar 3800 kW. Fuqia totale e instaluar N = 15 085 kW. HEC-et e shoqërisë “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., lidhen me rrjetin e transmetimit nëpërmjet N/ST 110/6.3 kV të HEC “Sllabinja 2E” me fuqi të instaluar 10 MVA dhe nëpërmjet N/ST 110/20/6.3 HEC “Sllabinja 2 D” me fuqi të instaluar 14.5 MVA.

- ERE me vendimin nr. 167, datë 05.08.2021, ndër të tjera ka vendosur të miratojë derogimin e kërkuar nga shoqëria “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., për një periudhë 24 muaj.
- Shoqëria “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr.1284/3 prot., datë 20.07.2023, ndër të tjera ka bërë me dije se: “...Për të realizuar të gjithë proceset e parashikuara kërkohet një afat prej 36 muaj që të mund të realizohet lëvrimi i paisjeve, instalimi dhe testimi i paisjeve pasi ndërfaqja ndërmjet paisjeve kineze të HEC dhe atyre ABB të OST paraqet vështirësi të medha. Në këto kushte kërkohet nga ERE zgjatjen e efekteve juridike të përcaktuara në pikën 1 gërma c të derogimit të përcaktuar me vendimin nr. 167, datë 05.08.2021. Zgjatja e efekteve juridike të vendimit nr. 167, datë 05.08.2021, prej një periudhe 36 muaj do të mundësonte realizimin e punimeve objekt kontrate dhe integrimin e plotë në sistemin SCADA të OST sh.a.”.
- Me qëllim konsultimin publik të kësaj kërkesë të bërë nga shoqëria “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., u realizua publikimi në faqen e internetit të ERE-s në rubrikën konsultime në datën 21.07.2023. Deri më datën e kësaj vendimarrje nuk rezultoi të jetë dërguar në ERE ndonjë opinion apo koment nga palët e interesit për kërkesën e shoqërisë “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., mbi zgjatjen e afatit të vendimit të bordit të ERE nr. 167, datë 05.08.2021.
- Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 256, datë 29.4.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të ministrave, “Për shpalljen e gjëndjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, vendosi se: Gjëndja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike i shtrin efektet deri më 31 dhjetor 2022”. Ndërsa me VKM-në nr. 650, datë 10.10.2023, vendosi shtyrjen e gjëndjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri në 30 Qershor 2023 si dhe me VKM-në nr. 449, datë 26.7.2023” vendosi zgjatjen e gjëndjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri në 31 Dhjetor 2023”.
- Derrogimi i kërkuar nga shoqëria “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k. dhe i miratuar nga ERE me vendimin nr. 167, datë 05.08.2021, me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, është aplikuar në kushtet e gjëndjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike. Shoqëria “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., ka kërkuar zgjatjen e efekteve juridike të përcaktuara në pikën 1 gërma (c) të derogimit të përcaktuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 167, datë 05.08.2021, edhe me 36 muaj të tjerë. Në pikën 1 gërma (c) e vendimit të ERE është parashikuar: “Afati i derogimit është për një periudhë 24 muaj”, duke qënë se vendimi është parashikuar të futet në fuqi menjëherë periudha 24 mujore fillon në datën 05.08.2021 dhe përfundon në datën 05.08.2023.
- Shoqëria “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., nuk ka kërkuar ndryshimin e objektit të derogimit, por vetëm zgjatjen e efekteve juridike të këtij derogimi, pa ndryshuar asnjë

element të tij. Në këto rrethana duke qënë se jemi duke vlerësuar të njëjtin objekt derrogimi të pandryshuar vlerësimet përkatëse janë trajtuar në mënyrë shteruese në procesin e vendimarrjes së bordit të ERE-s nr. 167, datë 05.08.2021.

- Detyrimet për lidhjen me sistemin SCADA të përdoruesve janë parashikuar në “Kodin e Transmetimit” të miratuar me vendim nr. 63, datë 11.04.2022, respektivisht neni 41 pika 3 gërma (d) ku përcaktohet se: detyrimi për Diagramin e telekomunikacionit dhe lidhja me sistemin SCADA të OST. HEC-et e Shoqërisë “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., nuk janë të lidhura me sistemin SCADA të OST sh.a., dhe vendimi i bordit të ERE-s nr. 167, datë 05.08.2021, respektivisht në pikën 1 gërma (b) ka përcaktuar se shoqëria “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., të vijojë të operojë e lidhur me sistemin e transmetimit duke marrë në konsideratë sa përcaktuar në këtë derrogim.
- Në këto kushte për shkak të shfuqizimit të “Kodit të Transmetimit” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, i ndryshuar dhe hyrjen në fuqi të “Kodit të Trasmemit” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 63, datë 11.04.2022, duhet të saktësohet pika 1 gërma (a) e parashikuar në vendimin nr. 167, datë 05.08.2021, si më poshtë vijon: *Derogimin/pezullimin e përkohshëm të përcaktimeve të nenit neni 41 pika 3 gërma (d) të Kodit të transmetimit miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 63, datë 11.04.2022, për njësitë gjeneruese të Shoqërisë HIDROPOWER ELEKTRIK sh.p.k..*
- Në kushtet e emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe kostot e shtuara si funksion i saj përbëjnë një situatë të paparashikuar më parë por shoqëria ka adresuar zgjidhjen duke gjetur kontraktorin për realizimin e punimeve pra ka realizuar një pjesë të procesit të punës së derrogimit dhe për rrjedhojë vlerësohet të mos ketë një afat më të gjatë kohor se ai i dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 167, datë 05.08.2021 që i përfshinte këto procese pune.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të pranojë pjesërisht kërkesën e shoqërisë “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k., mbi zgjatjen e afatit të vendimit të bordit të ERE nr. 167, datë 05.08.2021.
2. Pika 1 gërma (a) e parashikuar në vendimin e bordit të ERE-s nr. 167, datë 05.08.2021, ndryshon dhe bëhet: *Derogimin/pezullimin e përkohshëm të përcaktimeve të nenit neni 41 pika 3 gërma (d) të Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 63, datë 11.04.2022, për njësitë gjeneruese të shoqërisë “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k..*

3. Pika 1 gërma (c) e vendimit nr. 167, datë 05.08.2021 ndryshon dhe bëhet: *Afati i derogimit i përcaktuar në vendimin nr. 167, datë 05.08.2021, shtyhet për një periudhë 24 muaj deri në 05.08.2025.*
4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqërinë “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k. dhe shoqërinë OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**